



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 29.06.2016, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për organizmin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Pandeli Majko, Vasilika Hysi, Ulsi Manja, Vexhi Mucmata, Petrit Vasili.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Spartak Braho, Keltis Kruja, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Korajlka Bumçi, eksperte e Nivelit të Lartë

Artan Hoxha, ekspert i Nivelit të Lartë

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj - ... Mirëmëngjesi!

Fillojmë me mbledhjen në të cilën do të dëgjojmë një prezantim të projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

Për ta paraqitur projektin janë të pranishëm dy bashkëdrejtuesit e grupit të punës për drejtësinë penale, profesor Hoxha dhe zonja Bumçi që është gjithashtu bashkëkryetare nga EURALIUS-i.

Zoti Hoxha, urdhëroni!

Artan Hoxha – Mirëmëngjesi!

Meqenëse ky është projektligji i parë që propozohet në reformën për drejtësinë penale, dua të them se në kuadrin e reformimit të sistemit, një vend të rëndësishëm në reformat që propozohen është rishikimi i sistemit në tërësi, që vjen jo vetëm nga Kushtetuta, por edhe nga i gjithë legjislativi, që lidhet me organizimin dhe funksionimin e drejtësisë penale dhe që përfshin gjykatat, prokurorinë, policinë gjyqësore, ekzekutivin e vendimeve gjyqësore dhe në veçanti kodet, përfshi Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin Penal.

Në dokumentin analitik që ka verifikuar se si funksionon drejtësia penale sot në Shqipëri kemi konstatuar se është e nevojshme që në kuadrin e reformimit në drejtësi dhe reformim të thellë të ketë edhe drejtësia penale.

Ajo që kemi konstatuar është se procedimi penal ka defekte, të cilat vijnë jo vetëm si rezultat i mënyrës se si veprojnë prokurorët, gjyqtarët apo oficerët e policisë gjyqësore, por edhe defektet e sistemit.

Kështu që në këtë këndvështrim është një paketë e tërë që propozohet nën ndryshimet që shoqërojnë Kushtetutën. Janë rreth 8 ligje që mbulojnë drejtësinë penale. Dy nga ligjet prioritare, që shoqërojnë ndryshimet kushtetuese, sipas kalendarit që ju keni propozuar, është ligji “Për prokurorinë” dhe ligji “Për prokurorinë e posaçme dhe njësinë e posaçme hetimore”.

Për sa i përket ligjit “Për prokurorinë” dokumenti analitik ka konstatuar një proces politizimi të fortë të emërimit dhe përzjerjes së prokurorit të Përgjithshëm, mungesë kriteresh, që të garantojnë një vlerësim objektiv të kandidatëve. Ka konstatuar mungesë së pavarësisë së prokurorëve në kuadër të centralizimit të thellë të organit të prokurorisë në funksionimin, për shkak të Kushtetutës dhe të organizimit ligjor ku prokurori më i lartë ka autoritet të shfuqizojë edhe aktet e prokurorit më të ulët dhe në kuadrin e parimeve dhe standardeve europiane nuk garantohej pavarësia e brendshme e prokurorisë, ashtu sikurse edhe pavarësia e jashtme e prokurorit në raport me institucionet e tjera.

Njëkohësisht, është konstatuar një paqartësi në organizimin dhe funksionimin e raporteve prokurori dhe polici gjyqësore dhe për pasojë do të ketë edhe një projektligj, që shoqëron këtë paketë ligjore, projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” dhe ka një handicap shumë të madh sistemi, që ka të bëjë me vetëqeverisjen e prokurorisë, e cila sot aktualisht është nën autoritetin e prokurorit të Përgjithshëm. Ndërkohë që Këshilli i Lartë ose Këshilli i Prokurorisë ekzistues është një organizëm këshillimor për prokurorin dhe nuk ka asnjë funksion real për emërimin dhe disiplinimin e prokurorëve.

Në këto kushte prandaj vjen një paketë tërësore e propozuar, por që pjesë thelbësore e gjithë kësaj pakete është ligji “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë”, e cila prek edhe hapësira që lidhen me gjithë këtë legjislacion që propozohet për të garantuar këto mangësi që ka sistemi sot.

Ashtu sikurse edhe për projektet e tjera puna për hartimin e këtij projektligji ka filluar në tetor të vitit 2015, gati bëhet afërsisht një vit që punohet. Janë bërë shumë konsultime me prokurorë ato që quhen *Think tank*. Është një nga grupet që ka bërë shumë të tilla. 7 janë të regjistruara. Pavarësisht se ne kemi bërë edhe konsultime publike, ka pasur një veprimtari shumë të afërt dhe të koordinuar me misionin EURALIUS, në veçanti, por edhe me OBDAT-in. Kemi marrë konsulta edhe nga institucionet e tjera.

Në përfundim të gjithë këtij procesi konsultativ gjatë muajit prill dhe maj kemi pasur takime të gjera konsultative me prokurorë dhe kemi mbledhur në dy zona të mëdha, në Tiranë dhe Durrës, ku kemi pasur prokurorë, oficerë të Policisë Gjyqësore, profesorë, avokatë, njerëz të interesuar, studentë të interesuar për projektligjin.

Kemi pasur takime të mëdha konsultative. I kemi marrë në konsideratë të gjitha mendimet, që kemi mbledhur prej tyre dhe ajo që mund të identifikoj si një punë normale të

suksesshme ka qenë edhe pjesëmarrja e ekspertëve të opozitës. Në këtë grup ka qenë zoti Alibeaj, i cili ka qenë shumë konstruktiv. Ka dhënë mendime, të cilat janë diskutuar gjerë. Ka bërë propozime të dispozitave konkrete. Unë mendoj se shumica e gjërave që janë diskutuar kanë gjetur reflektim në draftin përfundimtar.

Për sa i përket përmbajtjes në vija të përgjithshme, na është dashur t'i ndjekim në ecuri zhvillimet e amendimeve kushtetuese, me qëllim që të reflektojmë në projektligj atë që Kushtetuta propozon për organin e prokurorisë. Janë disa dispozita të Kushtetutës, nga neni 148 deri në 149/ç, që është korpusi i normave kushtetuese, të cilave ne u referohemi në projektligj. Duke marrë shkas nga Kushtetuta dhe nga projektligji që e shoqëron atë, ajo që mund të themi ne si element thelbësor i ndryshimeve, që bëhen në organizmin e funksionimit të prokurorisë, është që prokuroria tashmë nuk konsiderohet si një organ i centralizuar, thellësisht i centralizuar, sikurse është me Kushtetutën aktuale. Për të realizuar standardet ndërkombëtare të funksionimit dhe të eficiencës së prokurorisë është futur elementi i decentralizimit i pavarësisë së prokurorit jo vetëm në gjykim, sikurse është sot, por edhe gjatë hetimeve paraprake.

Ky element thelbësor i ndryshimit të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë na ka vënë përpara situatës që do t'i japim zgjidhje të mësuarit për një kohë shumë të gjatë në Shqipëri, të një prokurorie hierarkike të centralizuar kur edhe ato propozime të prokurorit më të lartë ishin të detyrueshme për prokurorin më të ulët, ku prokurori më i lartë ka autoritetin të shfuqizojë aktet e prokurorit më të ulët, që në këtë kuadër ne të gjejmë mekanizma që prokuroria të mos humbasë orientimin në ushtrimin e funksioneve të tij.

Për këtë janë propozuar në projektligj dy elemente thelbësore: autoriteti i prokurorit të Përgjithshëm për të nxjerrë akte të karakterit të përgjithshëm, të karakterit detyrues të prokurorit të Përgjithshëm, por këtë edhe në kuadër të prokurorisë e ka edhe prokurori titullar apo drejtuesi i prokurorisë.

Ndërsa, për sa u përket çështjeve konkrete ,sepse kjo nuk është për çështje konkrete, ka të bëjë kryesisht me përcaktimin e politikave të ndjekjes penale të organizmit dhe funksionimit të prokurorisë, në projektligj parashikohet që prokurori mund të japë udhëzime. Titullari i prokurorisë mund të japë udhëzime jo të detyrueshme, por në çdo rast këto udhëzime jepen me shkrim, jepen të arsyetuara dhe prokurori, që nuk i ndjek ato, është i detyruar që arsyet, pse jo, t'i parashtrijë me shkrim, me qëllim që këto të mbeten të dokumentuara që në vazhdimësi të ecurisë së prokurorit të çështjes të mund të verifikohet më pas se cili është funksioni dhe si

është kryer funksioni nga prokurori i çështjes në raport me çështjen apo si është ushtruar funksioni i prokurorit titullar në raport me prokurorin dhe me prokurorin e çështjes.

Ky ka qenë një moment që ka pasur nevojë për shumë kujdes, me qëllim që rregullimet t'i garantojnë prokurorit pavarësinë në ushtrimin e ndjekjes penale dhe më pas në gjykimin e çështjeve.

Moment i dytë në këtë drejtim, por që nuk ka të bëjë me këtë ligj, por që ne mund ta paraqesim si problematikë është mënyra se si duhet të kontrollohen hetimet paraprake në garantimin e tyre, sepse ajo që ne kemi konstatuar është që faza më e dobët e procesit penal është faza e hetimit paraprak. Ajo që ndërton çështjen përpara se të vijë në gjykatë. Një çështje e dobët përpara se të arrijë në gjykatë nuk garanton vazhdimësinë dhe pastaj fillon efekti i *ping pongut* midis gjykatës dhe prokurorisë se cili e ka fajin.

Ndërkohë që hetimi paraprak është ai që garanton një gjykim. Kështu që në këtë pikëpamje mendimi i ekspertëve, që hartojnë projektligjin për prokurorinë, është që në procesin penal duhet futur një figurë e re, e cila bëhet e domosdoshme me decentralizimin e prokurorisë dhe që është kudo në vendet europiane dhe që quhet figura e gjyqtarit të audiencës paraprake ose e gjyqtarit të veprimeve paraprake.

Ajo që unë mund të them është se sot në projektin e propozuar të Kodit të Procedurës Penale, të ndryshimeve të bëra nga Ministria e Drejtësisë, nuk është propozuar figura e gjyqtarit për verifikimin e veprimeve paraprake.

Ne po punojmë, sepse jemi i njëjti grup që po punojmë edhe për verifikimin e saj, dhe në diskutimet tona mendojmë se ky subjekt i procesit penal në kushtet e decentralizimit të prokurorisë dhe me atë që prokurori shqiptar është mësuar në 50 vjet, të bëhet një figurë e rëndësishme, për të garantuar procesin penal jo vetëm për fazën e hetimit paraprak, por edhe për ta garantuar atë në gjykim.

Projekti ka një rregullim tërësor. Ne e mendojmë të plotë për kushtet dhe kriteret për emërimin e prokurorit të Përgjithshëm, sepse unë nuk i mora në mënyrë të renditur, për shkak se i kemi paraqitur këto me shkrim, por mora vetëm këto elemente thelbësore që ka projektligji.

Ne thamë që zgjedhja e prokurorit të Përgjithshëm sot nuk ka kriteret të forta, nuk ka procedurë garantuese dhe objektive, me qëllim që prokurori, kandidati, të jetë i përzgjedhuri si kandidati më i mirë.

Kushtetuta vetë është plotësuar me kushtet që përcakton për kandidatët për prokuror të Përgjithshëm. Këtyre kushteve ligji i ka bërë shpjegimet e mëtejshme dhe i ka shoqëruar me kritere. Po të shikojmë nenin 24 dhe në vazhdim të projektligjit është munduar për herë të parë në këtë projektligj që kriteret të specifikohen. Ka një normë të përgjithshme të kritereve që është neni 24 për vlerësimin e kandidatëve dhe pastaj janë 4 dispozita të tjera 25, 26, 27 dhe 28, të cilat shpjegojnë se cilat janë kriteret e vlerësimit profesional, cilat janë kriteret e vlerësimit të integritetit moral, cilat janë kriteret e vlerësimit të aftësive organizative, drejtuese dhe menaxheriale, që janë të rëndësishme për drejtimin e prokurorisë, si dhe cilat janë kritere të tjera vlerësimi, që kanë të bëjnë me disa aftësi të tjera plus që duhet të ketë prokurori i Përgjithshëm.

Mund ta them këtu që një kontribut të veçantë në formulimin e këtyre 4 dispozitave ka dhënë zoti Alibeaj. Ne e kemi falënderuar, por gjej rastin ta falënderoj edhe sot.

Nga ana tjetër, është përcaktuar edhe një procedurë se sa kohë duhet në dispozicion për paraqitjen e kandidaturës, pastaj si verifikohen kandidaturat, si e verifikon Komisioni i Këshillit të Lartë të Prokurorisë paraprakisht dhe si i skualifikon ata kandidatë, të cilët nuk plotësojnë kushtet që parashikon Kushtetuta, e drejta e ankimit kundër skualifikimit, që është në Gjykatën Administrative dhe më pas rankimi i kandidatëve të kualifikuar.

Ne kemi thënë (sepse mund të ketë shumë kandidatë, mund të jenë 20 apo 30) që seancën dëgjimore do ta kalojnë vetëm 6 kandidatë, jo 20, që mund të jenë kualifikuar si të tillë, sepse ka një seancë dëgjimore përpara Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe, sipas Kushtetutës, nga këta të 6-të, vetëm 3 do t'i propozohen Kuvendit. Edhe ky ka qenë një diskutim i gjatë ynë, eksperiencia e Kroacisë e të tjera, që të mos dëgjohej 20, 30 apo 40 kandidatë, por 6. Pra, ata që renditen më lartë, do të kenë dëgjesën, por përpara se të bëhet ky rankim, kandidatët kanë të drejtë të ankimojnë në Gjykatën e Apelit Administrativ rankimin përfundimtar që ka bërë Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Ky ankimim mund të mos ketë të bëjë me meritat, por me disa fakte, të cilat mund të mos jenë marrë në konsideratë ose me elemente procedurale.

Gjykata e Apelit Administrativ nuk mund të bëjë rankim të ndryshëm nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për shkak të një vlerësimi të ndryshëm të kritereve, sepse po t'i lejohej kjo gjykatës, atëherë gjykata do të merrte përsipër të zëvendësonte Këshillin e Lartë të Prokurorisë, gjë që, sipas Kushtetutës nuk e ka, por të verifikojë elemente, të cilat nuk janë marrë në konsideratë jo për elemente të meritës, por për elemente të faktit juridik: e ka këtë, nuk e ka këtë,

apo të procedurës që është ndjekur, gjykata mund ta bëjë. Nëse gjykata verifikon se ka shkelje të rregullave të përcaktuara, si dhe të rregullave të brendshme që nxjerr vetë Këshilli i Lartë i Prokurorisë në procedura, atëherë çështja i kthehet Këshillit të Lartë të Prokurorisë për të bërë një rikualifikim dhe rankim të kandidatëve, por, në çdo rast, ankimet gjyqësore nuk e ndërpresin procesin e verifikimit dhe vazhdimin e procedurave.

Për sa u përket procedurave për përzgjedhjen e prokurorit të Përgjithshëm, ne japim garanci të forta që kandidati për prokuror të Përgjithshëm të zgjidhet ai që është më i miri i kandidaturave.

Nga ana tjetër, mund të themi se ka një rregullim tërësor të mënyrës së organizimit dhe funksionimit të prokurorisë, të parashikuar në projektligj, si të strukturës së Prokurorit të Përgjithshëm, ashtu edhe të prokurorive pranë gjykatave sipas ndërtimit të tyre.

Nuk dua të hyj në detaje lidhur me këto, sepse do të diskutojmë nen për nen, por ajo që doja të thosha janë dy elemente të shprehura në ligj; është figura e zëvendësprokurorit të përgjithshëm dhe figurat e zëvendës drejtuesve titullarë të prokurorive, të cilët futen si elemente ligjore. Ata nuk janë zëvendës, në kuptimin që zëvendësojnë prokurorin e Përgjithshëm apo ai i prokurorisë së zakonshme zëvendëson prokurorin e Përgjithshëm, për çfarëdo situatë dhe me autorizimin e tij. Këto figura funksionojnë vetëm atëherë kur prokurori i Përgjithshëm ose prokurori titullar nuk janë në detyrë, pra nuk ndodhen. Autoriteti i këtyre figurave, po të shikojmë dispozitat konkrete, është i përcaktuar; ata nuk mund të marrin të gjithë autoritetin që ka prokurori i Përgjithshëm apo edhe prokurori, drejtuesi i prokurorisë.

Ka një kapitull që përcakton kompetencat e prokurorit të Përgjithshëm, që janë të gjitha të harmonizuara me Kushtetutën, por edhe me ligjin “Për organizimin e organeve të qeverisjes së gjyqësorit”, duke pasur në konsideratë autoritetin që ka Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Prokurori i Përgjithshëm dhe autoritete të tjera, që kanë të bëjnë me disa kompetenca, të cilat lidhen me organizimin dhe funksionimin e prokurorisë.

Në këtë projektligj futet si element i ri mbledhja vjetore e prokurorëve, por jo vetëm vjetore, si dhe mbledhja jo e prokurorëve në tërësinë e tyre, por e prokurorit të prokurorisë së përgjithshme dhe e prokurorëve të prokurorive, të cilët kanë kompetenca këshillimore për prokurorin e përgjithshëm. Mbledhja e prokurorëve ka edhe dy kompetenca, që janë vendimmarrëse: miratimi i përshkrimit e punës për të gjitha kategoritë e nëpunësve civilë, që funksionojnë në prokurori, si dhe vendos ngritjen e seksioneve dhe miraton strukturën e

prokurorisë. Këtë nuk ia kemi lënë prokurorit titullar, por ia kemi lënë mbledhjes së prokurorisë. Ne kemi futur si element të ri krijimin e seksioneve në prokurori, të cilat bazohen në kategori çështjesh dhe specializim prokurorësh. Prokurori titullar emëron drejtuesit e seksionit, kurse mbledhja e përgjithshme përcakton nëse duhet apo nuk duhet të ketë seksione.

Prokuroria e posaçme antikorupsion nuk rregullohet, sepse për të do të ketë një rregullim të veçantë, por ato që rregullohen në mënyrë të detajuar janë marrëdhëniet e prokurorisë me institucionet e tjera, siç janë: Kuvendi, Komisioni i Ligjeve, Këshilli i Ministrave, Policia Gjyqësore, me qëllim që prokuroria të ushtrojë funksionet e saj në raport me institucionet e tjera kushtetuese, që kanë të drejta dhe detyrime në luftën kundër krimit apo që e mbikëqyrin atë.

Një raport i veçantë vendoset për politikat që përcakton qeveria çdo vit në luftën kundër kriminalitetit, për të cilat prokurori i Përgjithshëm nxjerr udhëzime të karakterit detyrues për raportet e prokurorit me ministrin e Drejtësisë dhe në veçanti me Kuvendin ku prokurori, sipas Kushtetutës, duhet të raportojë minimalisht 1 herë në vit, njëkohësisht, edhe në Komisionin e Ligjeve. Ne kemi përcaktuar një rregull të veçantë, që ky komision të verifikojë paraprakisht raportin përpara se ai të diskutohet në seancë plenare.

Në vija të përgjithshme, ky ishte edhe relatimi për projektligjin “Për prokurorinë”.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Hoxha!

E thamë që në fillim që do të ishte një paraqitje e përgjithshme e projektligjit, që do t’u shërbente deputetëve të njiheshin me të dhe me qëllimet e hartuesve në draftimin e këtij projekti dhe njëherësh për t’u përgatitur për diskutimin në parim dhe për shqyrtimin nen për nen.

Zoti Manja do të jetë relator për këtë projektligj.

Fillimisht besoj do të kesh ndonjë pyetje.

Po, zoti Manja.

Ulsi Manja – Faleminderit, kryetar!

Në fakt, gjej rastin të përgëzoj ekspertët për projektligjin.

Ky projektligj, në tërësinë e tij, duket që është punuar me kujdes, për të reflektuar ndryshimin e madh që sjell projekti i amendimeve kushtetuese në lidhje me organizimin dhe funksionim e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë. Në funksion të diskutimit të këtij projektligji, qoftë në parim, qoftë nen për nen, për të qartësuar veten, kolegët e këtij komisioni, por edhe komunitetin e gjerë të prokurorëve dhe të oficerëve të Policisë Gjyqësore, që jam i

bindur janë njohur me këtë projektligj, kanë qenë pjesë e diskutimeve, por ata janë të interesuar të dinë diçka më hollësisht në lidhje me mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të prokurorisë me miratimin e këtij ligji.

Pyetja e parë dhe krejt normale për çdo prokuror është krejt e thjeshtë. Deri tani, duke u nisur nga përcaktimi i ligjit aktual, por jo vetëm nga ligji, edhe nga Kushtetuta, ne jemi mësuar të themi që prokuroria në Republikën e Shqipërisë është organ i centralizuar dhe unik i një lloji të veçantë *sui generis*. Ky është definicioni që njeh sot për prokurorinë komuniteti i prokurorëve dhe i gjyqtarëve, madje fjala *sui generis*, në diskutimet e brendshme të prokurorëve ka qenë që prokuroria nuk ka qenë as gjyqësor dhe as ekzekutiv. Me këtë parashikim kushtetues dhe me këtë projektligj që keni sjellë sot, pyetja ime e parë është: Çfarë do të jetë prokuroria në Republikën e Shqipërisë sot e prapa? Do të jetë pjesë e gjyqësorit apo do të anojë nga ekzekutivi? Kjo është një pyetje krejt normale.

Pyetja e dytë: Në kushtet e këtij decentralizimi të organit të prokurorisë, si e garanton projektligji qëndrueshmërinë e sistemit, duke pasur parasysh këtë traditë të centralizuar që kemi aktualisht?

Pyetja e tretë: Me këtë projektligj, cili është caku i ndërhyrjes së prokurorit më të lartë, në kuptimin e ligjit, për një procedim penal konkret?

Pyetja e katërt: Si garantohet procesi penal, duke u larguar nga modeli i centralizuar që kemi njohur deri tani?

Pyetja ime tjetër është: Futja e figurës së gjyqtarit të hetimeve paraprake, a mendohet se do të jetë garant i kësaj pavarësie procedurale që i jepet prokurorit të çështjes?

E fundit: Si garantohet në këtë projektligj pavarësia e prokurorit të Përgjithshëm?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Manja!

Kush do të përgjigjet?

Po, zonja

Korajlka Bumçi – (*flet anglisht*) Do t'u përgjigjem disa pyetjeve, kurse disa pyetjeve të tjera do t'ia lë zotit Artan t'u përgjigjet.

Për sa i takon qëndrueshmërisë së zyrës së prokurorisë, si do të sigurojmë ne që prokuroria të funksionojë vetë, me vullnetin e lirë dhe si do të sigurojmë ne, në një farë mënyre, të mos kemi shumë pavarësi në prokurori, këto do të bëhen nëpërmjet udhëzimeve të

përgjithshme dhe guidave të ndryshme që do të shikohen me shumë vëmendje në këtë draft, sepse ky është opinionin e Komisionit të Venecias. Ka disa opinione të Komisionit të Venecias në lidhje me këtë gjë, prandaj këto dy nene duhet të shihen me shumë kujdes.

Së dyti, seksionet që do të kryhen brenda zyrave të prokurorisë për të siguruar specializimin e prokurorive janë në përputhje me opinionin e “Venecias” dhe duhet të shihen me shumë kujdes. Pra, kështu kemi proceduar me udhëzimet e përgjithshme.

Ne, gjithashtu, kemi parashikuar që prokurori i Përgjithshëm të jetë i pavarur në ushtrimin e detyrave të tij, të cilat janë parashikuar në mënyrë shumë të qartë në këtë ligj.

Së treti, lidhur me decentralizimin e sistemit, dua të theksoj se në projektndryshimet e Kushtetutës nuk është parashikuar termi “prokuroria është e centralizuar” ashtu siç është tani. Nga ana tjetër, nuk është parashikuar as termi “prokuroria është e decentralizuar”, pra nuk janë parashikuar asnjëri prej termave. Kjo për faktin se ne do të kemi dy prokurori, SPAK-un dhe prokurorinë me një juridiksion të përgjithshëm, prandaj ndiqet edhe kjo logjikë në ligj. Tani do t’i jap fjalën zoti Artan Haxhi.

Artan Hoxha – Faleminderit!

Lidhur me pozicionin e prokurorisë në raport me pushtetet e tjera, ashtu si e tha edhe zoti deputet, nuk është se ka ndryshuar me atë që është propozuar me amendimet kushtetuese.

Ka pasur një tendencë që të bëhej pushteti gjyqësor, është diskutuar që mund të ishte funksion ekzekutiv, por në fund (mbase për shkak të traditës me të cilën jemi mësuar, por edhe sepse janë standarde), ka mbetur një autoritet që nuk është pjesë e pushtetit gjyqësor, por nuk është as pjesë e pushtetit ekzekutiv, ashtu siç thatë ju *sui generis*. Ajo që e ka bërë prokurorinë të afrohej më shumë me gjyqësorin është projektligji që është propozuar lidhur me organet e qeverisjes së gjykatave dhe prokurorive, i cili është një ligj i përbashkët.

Ligji që ka të bëjë me statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve, është një ligj i përbashkët dhe që e ka afruar shumë prokurorinë si një organ gjyqësor, pra e fut në autoritetet e drejtësisë, por jo nën ombrellën e organizimit gjyqësor, sepse secila ka organizimin e saj.

Ajo që është e rëndësishme dhe Kushtetuta e sjell si risi (në raport me atë që nuk është) është se organizimi gjyqësor ka një autoritet, që garanton: pavarësinë, mbarëvajtjen, ecurinë, emërimet, karrierën, disiplinimin e gjyqtarëve dhe është një strukturë me vete. Si dikur me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, sot është KLGJ-ja, e njëjta gjë formulohet sot në Kushtetutë lidhur me amendimet që propozohen për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë. Kjo do të

thotë se, ndryshe nga ç'është, sot propozohet Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me autorite të njëjta ose analoge sikurse ka KLGJ-ja, por pozicionimi i prokurorisë nuk ka ndryshuar në raport me pushtetet e tjera të qeverisë, vetëm se është forcuar dhe është qartësuar më mirë që prokuroria është një organ i pavarur. Ky është, si të thuash, një nga standardet e rëndësishme ndërkombëtare që prokuroria të jetë e pavarur, pavarësisht se ku pozicionohet. Amendimet kushtetuese, ligjet përkatëse, ky ligj dhe ligjet e tjera që unë përmenda, garantojnë pavarësinë e prokurorisë. Për ne kjo është thelbësore dhe me mënyrën se si prokurorët vijnë në detyrë, si disiplinohen që nga prokurori i Përgjithshëm dhe të gjithë pakurorët e tjerë, e bëjnë të mundur efektivisht këtë pavarësi nga pikëpamja strukturore, organizative dhe ligjore gjë që ka munguar deri më sot.

Si garantohet siguria e hetimeve, në kushtet kur ne jemi mësuar me një prokurori të centralizuar dhe tashmë krijon një prokurori që nuk është më e centralizuar?

Besoj se i thashë disa gjëra, por ajo që edhe Kora i përmendi, duke i bashkuar edhe me një pyetje që ju e shtruat për sa i përket gjyqtarit të hetimeve paraprake, garancia është: nëpërmjet udhëzimeve të karakterit të përgjithshëm dhe detyrues të prokurorit të Përgjithshëm; nëpërmjet politikave penale; nëpërmjet udhëzimeve të përgjithshme të prokurorëve titullarë në zbatim të udhëzimeve të prokurorit të Përgjithshëm.

Për çështjet konkrete janë orientimet dhe udhëzimet jodetyruese, duke vendosur disa raporte, disa mekanizma të prokurorit titullar me prokurorin e çështjes. Në mënyrë konkrete do t'i gjeni te kompetencat që ka prokurori në nenet 44, 50, 54, 47, 49, sepse të gjitha këto nene flasin për raportet, që krijohen midis prokurorit titullar dhe prokurorit të çështjes për çështje konkrete, të cilat kanë të bëjnë me orientimet që prokurori zakonisht i jep në fillim të çështjes për shkak të specifikës që ajo ka, por ligji parashikon edhe mundësinë që këto orientime dhe këto udhëzime t'i japë edhe në vazhdimësi dhe kjo është standarde. Edhe Komisioni i Venecias, që të ta kemi në vëmendje, na ka thënë se këto udhëzime duhet të jenë me shkrim. Prokurori që nuk i ndjek udhëzimet duhet t'i përgjigjet prokurorit titullar me shkrim, në mënyrë që këto të mbeten në aktet e procedimit, me qëllim që të verifikohen më pas.

Prokurorit titullar i jepet mundësia që nëse prokurori i çështjes është inaktiv, nuk zhvillon procedimet, tejkalon afatet e procedimit apo sillet në mënyrë abuzive me çështjen, t'i tërheqë çështjen, por kjo korrespondon edhe me dispozitën përkatëse të Kodit të Procedurës Penale. Ka edhe raste të tjera jashtë Kodit të Procedurës Penale, ku prokurori për shkak të pamundësisë mund të kërkojë dorëheqjen nga çështja.

Në kuadrin e këtij ligji që kemi propozuar, garantojmë që prokuroria të mos shpërbëhet si strukturë, por të ruajë unitetin e saj në ushtrimin e funksioneve, duke garantuar pavarësinë e prokurorit për ushtrimin e funksioneve të tij dhe rritjen e përgjegjësisë. Problematika që kemi ne sot është që prokuroi i çështjes fshihej pas prokurorit titullar dhe thoshte: “Unë kështu i kam urdhrat dhe udhëzimet:” dhe asnjëri nuk mbante përgjegjësi. Tani prokurori i çështjes duhet të ketë përgjegjshmëri dhe është independent për çështjet, sepse edhe nëse nuk i ndjek këto udhëzime, ai është i detyruar të shpjegojë pse nuk i ndjek.

Elementi i dytë që ne mendojmë se është i rëndësishëm, në kuadrin e një eksperience të gjatë, të centralizuar të prokurorisë, është që në Kodin e Procedurës Penale duhet futur verifikimi i gjykatës për përfundimin e hetimeve paraprake, të cilat kryhen nga gjyqtarët *udienza-s* paraprake, nga dhoma e madhe e jurisë, që e kanë amerikanët, me qëllim që gjykata, e cila nuk është gjykatë themeli, verifikon nëse ka çështje për në gjykatë apo nuk ka. Unë si prokuror nuk kam thjesht autoritetin që të përfundoj hetimet dhe ta kaloj çështjen për gjykim, sepse duhet ta bind paraprakisht gjykatën se kam dyshim të arsyeshëm, bazuar në prova, se çështja ime duhet të kalojë për gjykim. Këtë gjë e bën *l'udienza preliminare*, përveç asaj që ju i quani “gjyqtari i hetimeve paraprake” apo “GUP- i” në Itali, që te ne e bën një gjyqtar, që nuk gjykon çështjen e themelit. Me të dyja këto garantohet që sistemi jo vetëm të vazhdojë të punojë, por të punojë me një nivel të ndryshëm nga ai që ka punuar deri më sot.

Pyetja tjetër: si garantohet procesi kur vijmë nga një sistem i centralizuar? Si garantohet në ligj pavarësia e prokurorit të Përgjithshëm?

Ne mendojmë se këtë garanci prokurori i Përgjithshëm e ka marrë nga amendimet kushtetuese. Ai vjen në detyrë me një afat kohor 7-vjeçar, pa të drejtë riemërimi, në mënyrë që të mos ketë nevojë për të rregulluar pozicionet tij për një rimandatim. Diskutimi ka qenë për 7 apo 9 vjet, dhe ka mbizotëruar 7-vjeçar.

Sipas Kushtetutës prokurorit i garantohet një detyrë dinjitoze pasi të lerë detyrën e tij. Nga pikëpamja e ligjit, pavarësia e prokurorit garantohet: nga mënyra se si përzgjidhet kandidati më i mirë, pra integriteti i kandidatit fitues; nga pamundësia që autoritet nuk kanë që prokurorin e Përgjithshëm ta godasin me procedura që ligji nuk i parashikon. Është e dukshme që autoriteti i prokurorit të Përgjithshëm, i propozuar me ndryshimet kushtetuese dhe me ligjin që e shoqëron nuk është më ai që ka sot prokurorit i Përgjithshëm. Duke qenë sot autoriteti më i lartë që

disiplinon, që përcakton karrierën, që përcakton ecurinë e çështjeve, të gjithë jemi mësuar që të gjitha objektivat drejtohen te një person i vetëm.

Sot nuk ka më një person të vetëm, prokurori i Përgjithshëm ka aq kompetenca sa i lejon atij të administrojë Prokurorinë e Përgjithshme dhe të mbajë strukturën e prokurorisë në tërësinë e saj, por nuk ka kompetencat që ka sot. Unë jam i bindur se gjithë ai fokus politik, institucional që ka sot mbi prokurorin Përgjithshëm do të bjerë shumë shpejt. Sipas mendimit tonë, nga diskutimet që ne bëjmë, ky fokus do të shkojë më shumë te prokurori i Posaçëm Antikorrupsion se te prokurori i Përgjithshëm.

Fatmir Xhafaj - Në rregull!

Faleminderit, zoti Hoxha!

Zoti Mucmata!

Vexhi Muçmataj - Faleminderit, zoti kryetar!

Sot po diskutojmë në parim projektin “Për organizimin e prokurorisë” dhe mendoj se grupi i punës, i përbërë nga ekspertë të fushës, i cili ka punuar për një kohë të gjatë, ka arritur që të paraqesë pranë nesh një projekt të studiuar, të balancuar mirë për të harmonizuar drejt kompetencat e prokurorëve, të drejtuesve të prokurorisë dhe të drejtuesit të Prokurorisë së Përgjithshme ose prokurorit të Përgjithshëm.

Natyrisht, grupi i ekspertëve vendas dhe të huaj meritojnë një falënderim të veçantë. Unë e kam parë projektin dhe e kam studiuar.

Pyetja ime, meqenëse zoti Ulsi e ezauroi pjesën më të madhe të pyetjeve, si e shikoni, si e vlerësoni ju mënjanimin ose heqjen e kompetencave të prokurorit ose të zyrës së prokurorit të Përgjithshëm për kontrollin e hetimeve paraprake? A vlerësoni që mund të dobësojë efektivitetin e hetimeve?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ju lutem, kush do të përgjigjet?

Artan Hoxha – Në analizën që i është bërë funksionimit të organit të prokurorisë, atje ku mendohet se efektiviteti mbështetet tek autoriteti më i lartë, ndoshta aty është edhe defekti i mekanizmit të sistemit, sepse dhënia e autoritetit prokurorit të Përgjithshëm në kontrollin e hetimeve paraprake, autoritet jo thjesht i orientimeve të udhëzimeve, siç është sot, autoritetin që të urdhërojë veprime, të shfuqizojë akte, ne kemi vlerësuar se në dukje forcon efektivitetin e hetimeve, por, në fakt, i dobëson, sepse i përqendron në autoritetin e prokurorit më të lartë. Pra,

është një balancë që, kur priset diku, do të rregullohet diku tjetër, sepse ne konstatojmë se hetimet paraprake janë defekte sot në Shqipëri dhe janë me këtë autoritet, jo vetëm me prokurorin e Përgjithshëm, por edhe prokurorin titullar.

Nga ana tjetër, kjo nuk garanton pavarësinë e prokurorit, që është standard ndërkombëtar, ndaj ajo që është munduar të bëhet, si me propozimet kushtetuese, ashtu edhe me propozimet ligjore, është që të mos humbasë autoriteti i prokurorit më të lartë dhe i prokurorit të Përgjithshëm. Të mbetet ky autoritet, por të mos mbetet si autoritet urdhërues, dominues, që merr përsipër të gjithë strukturën. Ne nuk mendojmë se dobësohet efektiviteti i hetimeve, sepse prokurorit të Përgjithshëm i hiqet kompetenca të shfuqizojë aktet e prokurorit më të ulët.

Por nga ana tjetër ne mendojmë se, duke i dhënë autoritet prokurorit të Përgjithshëm që të orientojë praktikën, udhëzimet detyruese, duke i dhënë autoritet prokurorit të Përgjithshëm për Prokurorinë e Përgjithshme të udhëzojë për çështje konkrete, njëkohësisht duke i dhënë autoritet prokurorit titullar të japë orientime të karakterit të përgjithshëm, me shkrim, të detyrueshme dhe të japë orientime, udhëzime jodetyruese për çështjet konkrete, i themi se ka edhe mekanizma, si për shembull: neni 44 thotë: “Kërkon informacion për ecurinë e procedimeve, dhe nëse është e nevojshme, nxjerr udhëzime sipas këtij ligji”, pra, ka mjaft mekanizma. Unë lexova vetëm një, që jemi në kufijtë e respektimit të pavarësisë së prokurorit me këto rregullime që ne bëjmë.

Për shkak të shqetësimit që keni ju, zoti deputet, ju jeni mësuar me një strukturë të centralizuar dhe ne mundohemi ta mbajmë si strukturë, por jo të centralizuar, por si një strukturë që të funksionojë si e tërë. Ne nuk kemi asnjë lloj tagri të tejkalojmë Kushtetutën, sepse ne propozojmë ligj mbi atë që është përcaktuar në Kushtetutë dhe Kushtetuta thotë se prokurorët janë të pavarur. Në këtë pikëpamje ne kemi bërë rregullime të tilla që ta ruajmë strukturën e prokurorisë, të ruajmë veprimtarinë të tillë, duke garantuar në anën tjetër pavarësinë e prokurorit të çështjes dhe rritjen e përgjegjshmërisë, disiplinimit të tij dhe mosmbulimit me autoritetin e prokurorit më të lartë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Kam tri gjëra, duke vazhduar në logjikën e asaj që u trajtua, por edhe pa përsëritur kolegët.

E para, nuk ju krijohet përshtypja se ka një mosreflektim të parashikimeve të reja kushtetuese në projektin e ri kushtetues për rolin e këshillit të ri të prokurorisë, raportin e këtij

këshilli të ridimensionuar tashmë, jo thjesht në nivel kushtetues, por edhe nga pikëpamja e kompetencave me prokurorin e Përgjithshëm, me prokuroritë e rretheve gjyqësore?

Së dyti, nuk arrij të kuptoj pse e keni futur këtu konceptin e mbledhjes së përgjithshme të prokurorëve? Çfarë është mbledhja e përgjithshme e prokurorëve? Është organ vendimmarrës, organ konsultativ? Këto janë organe shtetërore, nuk janë shoqata. Mund të kenë nevojë të konsultohen, mund të ketë nevojë të tërhiqet mendimi i prokurorëve për çështje të caktuara, por e ngritur si insion, mbledhja e përgjithshme e prokurorëve deformohet dhe po ashtu edhe një pjesë e funksioneve të reja kushtetuese që i kalojnë këshillit, që i kalojnë prokurorit të Përgjithshëm e të tjera. Pra, kjo është shumë e paqartë, për të mos thënë se nuk shkon në të njëjtën linjë me konceptin, me logjikën që është ndjekur në projektin kushtetues, por edhe te ligji për organizimin e pushtetit gjyqësor.

Këtu dua të dal te një çështje e tretë. Ka disa zgjidhje që janë shumë të mira. Për shembull, rasti i buxhetit e të tjera, që do të jetë e nevojshme të shihen si modele te ligji për organizimin gjyqësor.

Por, nga ana tjetër, shikoj që disa elemente shumë të mira të ligjit për organizimin e pushtetit gjyqësor duhet të përfshihen këtu, ose, së paku, të harmonizohen, sepse, pavarësisht veçorive që kanë organet nga pikëpamja e strukturimit, e funksionimit të tyre, ato kanë shumë pika prerjeje dhe nuk kemi pse të zbatojmë standarde të ndryshme brenda të njëjtit shtet. Është moment shumë i mirë që jemi ne që i shqyrtojmë të dyja këto projekte në të njëjtin komision, në të njëjtin Kuvend, në të njëjtën kohë, pavarësisht se ju mund të keni qenë grupe pune të ndryshme.

Çështja e katërt që kam lidhet me administratën. Këtu ndoshta është pjesa që unë nuk jam shumë optimist për të thënë fjalë të mira për projektin, sepse nuk sjell asnjë ndryshim nga mënyra si e kemi sot administratën e prokurorisë. Të mos harrojmë se shumë probleme që kemi sot në gjyqësor, apo shumë probleme që kemi sot në prokurori nuk lidhen vetëm me gjyqtarë dhe me prokurorë, lidhen edhe me administratën që është në shërbim të tyre, qoftë nga pikëpamja e efencës, qoftë nga pikëpamja e korrupsionit, qoftë edhe nga pikëpamja e profesionalizmit. Një pjesë e mirë e nëpunësve të administratës gjyqësore dhe administratës së prokurorisë janë njerëz të emëruar në atë punë për të bërë qoka personale apo politike. Tani, në qoftë se në një moment të caktuar ne u japim këtyre status dhe ligjërojmë këtë situatë, kaq të kritikueshme edhe nga ju kur keni bërë analizat përkatëse, nuk më duket shumë korrekte. Ndërkohë, edhe administrata e re

që duam të ndërtojmë, që është një komponent shumë i rëndësishëm në funksionimin e sistemit, nuk mund të kalojë me një nen, me dy nene, apo me një referencë të ligji për shërbimin civil.

E fundit, për ta mbyllur, është dispozita kalimtare. Kam përshtypjen se ju jeni kujdesur më shumë për njerëz konkretë në prokurorinë e Përgjithshme, sesa për disa dispozita kalimtare që caktojnë rregulla të përgjithshme. Për shembull, pjesa e administratës, ndërkohë që do t'i nënshtrohen vetingut, kontrollit e të tjera, në dispozitat kalimtare nuk është reflektuar.

Këto janë pak a shumë disa sugjerime, apo komente të përgjithshme, të cilat, të marra në formën e shqetësimit, apo të pyetjeve, do të doja të kisha një reflektim paraprak. Por, duke i thënë këto, duhet njëkohësisht të paraprij diskutimin që këto do të jenë disa nga çështjet për të cilat besoj se do të insistojmë fort gjatë shqyrtimit të projektit në ditët në vijim.

Urdhëroni!

Artan Hoxha – Me përjashtim të pyetjes për mbledhjen e prokurorëve, do të doja t'i jepja një përgjigje Korës. Për rolin e këshillit të prokurorisë, ajo që ishte si pyetje dhe si vërejtje është se nuk reflektohet kjo marrëdhënie me prokurorin e Përgjithshëm, me prokuroritë dhe në tërësinë e vetë edhe nevoja për një koordinim të këtij ligji me rregullimet e tjera ligjore. Mund të them se ne kemi pasur më shumë se një javë punë intensive me përfaqësuesit e hartimit të disa projektligjeve që lidhen me ligjin për prokurorinë dhe e kemi koordinuar këtë projektligj me projektligjet e tjera, siç është ligji për organizmin dhe funksionimin e organeve të vetëqeverisjes së drejtësisë, ligji për statusin dhe karrierën e gjyqtarëve, ligji për organizimin gjyqësor dhe, në këtë kuadër, është arritur që gjërat që janë diku, të mos përsëriten në ligjin tjetër dhe në rastin më të keq, të mos kemi rregullime, të cilat bien ndesh me njëra-tjetrën. Ajo që ne kemi thënë në këtë projektligj është se marrëdhëniet që lidhen me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, të prokurorëve, të prokurorit të Përgjithshëm, veç atyre që rregullon ky ligj në mënyrë specifike, rregullon ligjet e posaçme. Aty flitet për karrierën, për statusin, flasin se si disiplinohen, si verifikohen, përfshijnë edhe prokurorin e Përgjithshëm, që do të thotë se ne mund të kishim dy mënyra për ta rregulluar: ose t'i merrnim, për shembull, rregullimet që kanë të bëjnë me statusin dhe me organizmin e prokurorisë dhe ta kishim pjesë të këtij ligji; ose do të bëjmë atë që është ndjekur, që pjesët organizative dhe funksionale ia lëmë një ligji të veçantë dhe pjesët e vetëqeverisjes dhe të disiplinimit të karrierës ia lëmë legjislacionit tjetër.

Ne mund të rishikojmë edhe një herë nëse kemi gjëra që na kanë mbetur jashtë, por nga verifikimi dhe koordinimi që kemi bërë me Agnesin, por edhe me të tjerë, që kanë punuar me

ligjet e tjera, mendojmë se ato që nuk janë të rregulluara këtu, janë të rregulluara në ligjin e posaçëm për funksionimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Po iki nga mbledhja e përgjithshme e prokurorëve dhe po vij te “të harmonizohet me organizmin gjyqësor si ligj”. Ka gjëra që nuk i gjejmë në këtë projekt, që janë në projektligjin “Për organizmin gjyqësor” dhe mund të ishin edhe në projektligjin “Për prokurorinë”. Ndoshta mund të jenë dhe ne nuk i kemi pasur. Domethënë, nuk po them në mënyrë të prerë, por në punën intensive mendoj se ne kemi marrë rregullime të atij ligji dhe ata kanë marrë rregullime të ligjit tonë. Për ndonjë gjë konkrete, që nuk kanë strukturim të njëjtë, ne mund ta verifikojmë me Korën dhe me Agnesin. Ne po e rishikojmë dhe po reflektojmë eventualisht.

Për administratën e prokurorisë, jo se këtu nuk ka nevojë, sepse këtu ka aq rregullim, sa ne mendojmë se është i mjaftueshëm në këtë ligj, por rregullim të mëtejshëm për administratën e prokurorisë, ashtu sikur edhe për administratën

gjyqësore ka ligje për statusin e gjyqtarëve dhe të administratës, që e mbështetin gjykatën edhe prokurorinë, përveç atyre rregullimeve që kanë të bëjnë me ligjin “Për shërbimin civil”, i cili, në fakt ka mbetur me atë rregullim që ka qenë dhe që është struktura e organizimit në tërësinë e vet, me sekretarin e Përgjithshëm. Edhe këtu, ne kemi pasur debate, me thënë të drejtën, por kjo është një çështje që jashtë debatit vjen në propozimin që ofrohet. Ajo që ne ndoshta duhet të themi këtu është që, ashtu siç referojmë në ligjin “Për statusin dhe në Kodin në Punës, duhet të referojmë edhe në ligjin për administratën gjyqësore dhe administratën e prokurorisë.

Ndërsa për dispozitat kalimtare, e vetmja dispozitë kalimtare që ka të bëjë jo me individët, por me strukturën është inspektimi, që tashmë inspektimi nuk është më i prokurorit të Përgjithshëm, nuk është më i ministrit të Drejtësisë dhe meqenëse ne kemi tashmë një strukturë të ndërtuar atje ajo që është menduar është garantimi i verifikimit të kësaj strukture në kuadër të Inspektoratit të Kontrollit të Prokurorëve dhe që në këtë pikëpamje është një dispozitë tranzitore e përgjithshme që nuk është se thotë ndonjë të madhe, thjesht thotë që këta verifikohen. Por edhe këtu, ashtu sikurse ju me të drejtë e thatë dhe unë e pranoj si një mungesë të projektit, ne duhet t’i referohemi ligjit për vetingun dhe ashtu sikurse e gjithë struktura tjetër që do verifikohet për efekte të kriterëve për të qëndruar në detyrë apo për të vajtur në një detyrë, duhet po ashtu të ketë edhe ajo referencën ligjore dhe kjo bën edhe lidhjen me legjislacionet e tjera që janë të hartuara dhe që janë në proces verifikimi.

Kështu që unë si shënim mbajta që të bëjmë referencën në legjislacionin e posaçëm që rregullon jo vetëm veprimtarinë e prokurorëve dhe verifikimin e tyre, por edhe të administratës në funksion të tyre. Për sa i përket mbledhjes së përgjithshme, ajo nuk është mbledhja e përgjithshme e prokurorëve, është mbledhja e prokurorit të Prokurorisë së Përgjithshme dhe mbledhja e përgjithshme dhe mbledhja e prokurorëve të secilës prokurori. Ideja e ndërkombëtare është, dhe kjo vjen edhe nga Komisioni i Venecias më duket, diku e ka thënë, që prokuroria duhet të ketë mbledhjen e strukturës për të përcaktuar, për të orientuar, për të këshilluar, për të verifikuar dhe për të ndihmuar dhe orientuar në funksionimin e prokurorisë, por jo mbledhja e përgjithshme e prokurorëve. Nuk ka mbledhje të përgjithshme të prokurorëve, ka mbledhje të prokurorëve të strukturave dhe në këtë kuadër mbledhja e prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme nuk ka funksione vendimmarrëse. Po ta shikosh, shqyrton planin e punës, raportin e prokurorisë, jep mendime për rregulloren, jep mendime për projektudhëzimet e prokurorit, evidenton problematika për ligje dhe akte normative, jep mendime lidhur me raportin e punës të prokurorisë, diskuton çështje të rëndësishme të prokurorisë, nuk ka funksione vendimmarrëse. I vetmi moment në funksionet vendimmarrëse është për mbledhjen e prokurorëve të prokurorisë të tjera, përveç këtyre funksioneve këshillimore, dhënieve të ideve për rregulloren e brendshme e të tjera, i kemi dhënë dy funksione:

E para, miraton përshkrimin e punës të të gjitha kategorive të nëpunësve civilë dhe të punonjësve të prokurorisë dhe përshtat strukturën standard që nxjerr Prokuroria e Përgjithshme me nevojat e prokurorisë dhe aftësitë e personave në detyrë.

E dyta, e cila është vendimmarrëse, është që vendos ngritjen e seksioneve dhe miraton strukturën përbërëse të tyre kur vetë seksionet ndërtohen në mënyrë nominative nga prokurori titullar, dhe nuk e kanë konsideruar ndërkombëtarët këtë si çështje të karrierës, sepse po ta konsideronin, atëherë do të hynte në funksionet e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, por e kanë konsideruar si çështje të organizimit të brendshëm ku seksionet nuk janë definitive. Seksionet krijohen në raport me problematikën, në raport me cilësinë dhe eksperiencën e prokurorëve me qëllim që të ndihmojnë luftën kundër krimit në një fushë të caktuar. Kjo është ajo që unë mund të them në vija të përgjithshme, por koha mund të japë disa opinione më specifike.

Korajlka Bumçi – *(flet anglisht)* Duhet të pranoj që Artani e shpjegoi shumë mirë dhe nuk kam se çfarë të shtoj, por do të thosha se mbledhja e përgjithshme në Prokurorinë e Përgjithshme dhe takimet e veçanta në prokuroritë e veçanta janë parashikuar në një farë mënyre,

për të hequr atë barrën e pushtetit nga drejtuesit e prokurorive dhe nga Prokuroria e Përgjithshme, për të pasur një ndarje të pushtetit dhe për të parë edhe opinionet e të tjerëve, prandaj detyrat që janë parashikuar në ligj janë shumë specifike dhe janë shumë të qarat do të thosha. Është njësoj si mbledhjet që bëhen me gjyqtarët, sigurisht Artani e tha shumë mirë që në fillim, pra mund të themi që ne kemi këto takime i kemi edhe Kroaci shumë suksesshme dhe kemi një përvojë shumë të mirë, por, sigurisht që mund të diskutojmë lidhur me to edhe më tej.

Fatmir Xhafaj – Me sa shoh, nuk ka pyetje të tjera të natyrës së përgjithshme, kështu që është e arsyeshme ta mbyllim këtu çështjen për t’u dhënë mundësinë kolegëve, pasi kanë dëgjuar përgjigjet e pyetjeve dhe pa dyshim ekspozenë e paraqitur në mënyrë shumë profesionale nga profesor Hoxha dhe zonja Bumçi, për të vazhduar më tej me fjalën e koment vlerësimit të relatorit, pyetjet specifike dhe diskutimet konkrete për ta votuar në parim në mënyrë që pastaj t’i hapim rrugë shqyrtimit nen për nen.

Mbledhja e ardhshme për shqyrtimin e këtij projektligji do të njoftohet, mund të kemi një zhvendosje në kalendar me kërkesën e dy bashkëkryetarëve, por do të konsultohemi me kalendarin dhe hapësirat që ka komisioni për ta precizuar datën e saktë për të cilën do t’ju njoftojmë. Ndërkohë relatori së bashku me këshilltarin të përgatiten për paraqitjen e qëndrimit të tij dhe njëkohësisht për t’i hapur rrugë votimit në parim.

Dakord, këtu e mbyllim këtë çështje dhe mbledhjen për sot për të vazhduar ditën e premtë sipas kalendarit të punës së komisionit me projektligjet e tjera që janë për shqyrtim.

Faleminderit, zonja Bumçi!

Faleminderit, zoti Hoxha!

Faleminderit ekipit tuaj dhe njëkohësisht edhe stafit tonë të Kuvendit! Natyrisht, dua të falënderoj dhe të gjithë ata ekspertë të nivelit të lartë, ekspertët e sekretariatit teknik që kanë shërbyer dhe që kanë punuar për muaj të tërë pranë këtij grupi pune në tërësi për shtyllën e reformimit të drejtësisë penale, por në veçanti për këtë projektligj dhe shpresoj që edhe në mbledhjet e ardhshme ata të jenë prezentë dhe, nëse kanë nevojë që të shprehen edhe vetë, mund të shprehen drejtpërsëdrejti në këtë komision, i cili është i hapur për çdo lloj komenti të bërë nga ekspertët në funksion të një vendimmarrje sa më cilësore.

Faleminderit të gjithëve!

Faleminderit edhe zonjave të nderuara që shërbyen për përkthimin e kësaj seance!

Faleminderit!

Faleminderit!

MBLEDHJA MBYLLET

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga stafi teknik i angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë